



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIK OF KOSOVO**



**KOMUNA E LIPJANIT**  
**OPŠTINA LIPLJAN**  
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

---

## **DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

|             |   |
|-------------|---|
| Datë:       | <b>06.04.2018</b>   |
| References: |   |
| Për :       | <b>Z. Imri Ahmeti</b> - Kryetar i Komunës së Lipjanit   |
| Kopje :     | <b>Z. Fauz Xhemjali</b> - Nënkyetar i Komunës<br><b>Z. Lulzim Qerimi</b> – Nënkyetar për Komunitet<br>Arkiven |
| Nga:        | Bekim Shabani - Drejtor i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport   |
| Lënda:      | <b>RAPORT -- Mujor -- Mars - 2018</b>   |

I nderuar Kryetar,

Gjatë muajit Mars në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale.

Në raportimet javore e kemi paraqitur përafërsisht punën e drejtoratit.

Zyrtarët nëpër sektorë janë angazhuar maksimalisht në kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi që kanë.

## AKTIVITETET GJATË MUAJIT MARS 2018

- Kemi bërë raportin mujor Shkurt 2018,
- Kemi organizuar dhe bërë homazhe tek Shtatorja “Adem Jashari” për nder te Epopesë së UÇK-së ne Sheshin e Qytetit të Lipjanit, me date 06.03.2018,
- Kemi mbajtur disa takime me futbollistet trajnerin e klubit futbollistik “Ulpiana”
- Në bashkepunim me Agjensionin Shtetror të Arkivës se Kosovës kemi hapur Ekspozitën për nder të përvjetorit të Epopesë së UÇK-së, dhe ditës së mësuesit, ekspozita ka qene e hapur në objektin e Bibliotekës dhe Arkives së qytetit, tema e ekspozitës: Dëbimi i Shqipëtareve nga Sanxhaku i Nishit 1877/78, ekspozita ka qene e hapur per 3 ditë rresht ku kanë pasur mundesi të vizitojnë profesor, student, nxënës, dhe gjithë qytetaret.
- Mbyllja e ekspozitës është bërë me 09.03.2018, në ora 18:00h,
- Kemi zhvilluar një takim me nenkryetarin e komunës së Ferizajt, qellimi takimit ka qene bashëpunimi në fushen e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Kemi bërë kërkesa për fillimin e procedurave të prokurimit per investimet kapitale ne fusha sportive dhe salla sportive,
- Në qendrën kulturore “Tahir Sinani” është shfaqur një program kulturoro-artistik nga nxënësit e shkollës “Ismail Luma” Lipjan,
- Kemi lëshuar dy pëlqime për shfrytëzimin e qendrës kulturore “Tahir Sinani”
- Kemi pasur takim me disa pjestarë të KFOR-it, nacionalitetit Turk, ku në ate takim biblioteka ka pranuar dhuratë 4 Libra për lexuesit – personat me nevoja të veqanta,
- Zyrtari nga drejtorati ynë ka marrë pjesë në trajnim me RELOAD për dy ditë radhazi, në Prizren,
- Më një kërkesë kemi kërkuar paramasat dhe parallogaritë dhe projektin detal për fusha sportive dhe objekte sportive,
- Kemi bashkëpunuar me auditorin ne kontekst të veqant disa arsyetime të klubeve sportive,
- Kemi bërë Thirrje Publike për Aplikim të Subvencioneve për Klube Sportive më 15.03.2018, konform Rregullores të Ministrisë së Financave NR.04/2017, mbi kriteret, standartet dhe procedurate financimit public të OJQ-ve,
- Kemi nënshkruar një memorandum bashkëpunimin me OJQ–në LYC,(Youth Center),
- Në cilsinë e monitoruesit kemi qene pjesmarrës në kuvendin e jashtëzakonshëm të thirrur nga klubi futbollistik Ulpiana i mbajtur më 19.03.2018, në Sallen e Kuvendit Komunal në Lipjan,
- Kemi plotësuar formularin e vlersimit të rrezikut dhe monitorimit te projektit,
- Dërgimi i listës së objekteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtjen e përkohshme derguar zyrës për informim Komuna e Lipjanit,

- Kemi përpiluar një listë të projekteve dhe objekteve kulturore dhe sportive të cilat janë realizuar për 4 vitet e fundit,
- Kemi marrë pjesë në puntorine në sallën e KK Lipjan, të organizuar nga Drejtoria e Urbanizmit në bashkëpunim me GIZ, me temën: Hartimi i Hartës Zonale ,
- Zyrtari nga drejtorati ynë ka marrë pjesë në punën e planit të integritetit,
- Kemi bërë vizite në lokacionin e propozuar për ndërtimin e xhamisë në fshatin Llugaxhi,
- Kemi organizuar dhe bërë homazhe për nder të dëshmorit Ismet Asllani më 24.03.2018,
- Zyrtari nga drejtoria ynë konkretisht nga sektori i arkives ka bërë kontrolle dhe mbikqyrje të materialit arkivor në Shkollën Filllore “Vëllezrit Frashëri” në Lipjan,
- Kemi bërë Thirrje Publike për Aplikim të Subvencioneve për Organizata të Shoqërisë Civile më 28.03.2018, konform Rregullores të Ministrisë së Financave NR.04/2017, mbi kriteret, standartet dhe procedurat financimit public të OJQ-ve,
- Kemi bërë vizitë lokacionin ku do të ndërtohet fusha sportive në fsh. Resionovc,
- Kemi zhvilluar takim me përfaqësuesit e fshatit Hallaq, Ribar i Vogël, dhe Sllovi, qëllimi takimit kordinimi i agjendes me rastin e 19 vjetorit të rënjes së Dëshmoreve dhe Martireve në Komunën e Lipjanit,
- Zyrtari nga drejtoria ynë ka dhënë një interviste në RTK (Radion Televizionin e Kosovës), tema rreth aktiviteteve kulturore të komunës së Lipjanit ,
- Kemi zhvilluar takim më shefin e kulturës në komune e Pejës, në Pejë, për bashkëpunim në fushën e kulturës në mes të dy komunave përkatëse,

**AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR-- Të përshkruhen në detaje  
aktivitetet që janë në implementim e sipër për muajin raportues.**

- Pranimi, shqyrtimi dhe arkivimi i lëndëve ditore,
- Sektori i Arkivit dhe ai i Bibliotekës janë duke ju ofruar shërbime palëve sipas kërkesave të tyre,
- Qendra Rinore Sportive në Lipjan ka punuar sipas orarit dhe kërkesave të klubeve sportive,
- Jemi në vazhden e takimeve dhe organizimit për përvjetorin e 19 të Rënjes së Dëshmoreve dhe Martirëve të komunës së Lipjanit

## Takimet me Palë

- DKRS-ja në vazhdimësi ka takime me qytetarë, përfaqesues të klubeve sportive të Ojq-ve për t'u interesuar rreth kërkesave të ndryshme dhe për t'u pajisur me pëlqime - orare për mbajtjen e aktiviteteve,

Në vazhdim paraqesim raportin në formën tabelare:

### 1. ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT

Tabela-1, -- Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët

| Gjithsejt | Të Aprovuara | Të Refuzuara | Në Procedurë | Të Pazgjidhura |
|-----------|--------------|--------------|--------------|----------------|
| 5         | 4            | 1            | -            | -              |

Tabela- 2, -- Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

| Kërkesat e parashtruara | Të realizuara | Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi) | Në proces | Vërejtje             |
|-------------------------|---------------|---|-----------|----------------------|
| 16                      | 9             | 83  | 7         | Janë inkasuar 41.50€ |

Tabela- 3, -- Raport për Biblotekën e Qytetit në Lipjan

| Vendi                  | Libra në huazim | Libra të kthyera | Lexues te rinj | Përpunim i librit | Lexus në sallën e leximit |
|------------------------|-----------------|------------------|----------------|-------------------|---------------------------|
| Spektori për fëmijë    | 370             | 470              | 93             | -                 | 225                       |
| Spektori për të rritur | 145             | 128              | 8              | -                 | 769                       |

**Tabela- 4, -- Raport për Biblotekën në Gadime**

| <b>Libra në huazim</b> | <b>Libra të kthyera</b> | <b>Lexues te rinj</b> | <b>Përpunim I librit</b> | <b>Lexus në sallën e leximit</b> |
|------------------------|-------------------------|-----------------------|--------------------------|----------------------------------|
| <b>211</b>             | <b>199</b>              | <b>47</b>             | <b>0</b>                 | <b>0</b>                         |

**Tabela- 5 -- Raport për Biblotekën në Ribar i Madhë dhe Magure**

| <b>Libra në huazim</b> | <b>Libra të kthyera</b> | <b>Lexues te rinj</b> | <b>Përpunim I librit</b> | <b>Lexus në sallën e leximit</b> |
|------------------------|-------------------------|-----------------------|--------------------------|----------------------------------|
| <b>119</b>             | <b>98</b>               | <b>16</b>             | <b>0</b>                 | <b>0</b>                         |

**Tabela- 6, -- Raport për Biblotekën në Shalë**

| <b>Libra në huazim</b> | <b>Libra të kthyera</b> | <b>Lexues te rinj</b> | <b>Përpunim i librit</b> | <b>Lexus në sallën e leximit</b> |
|------------------------|-------------------------|-----------------------|--------------------------|----------------------------------|
| <b>148</b>             | <b>123</b>              | <b>25</b>             | <b>0</b>                 | <b>0</b>                         |

Mars 2018